



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ për vitin 2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:
 - 1.1. Projektligji i Punës dhe Projektligji dhe për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror fuzionohen në një projektligj të vetëm;
 - 1.2. Projektligji i Punës (MPMS) afati i miratimit 15.12.2020.
2. Shtohet në Programin Legjislativ për vitin 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ky projektligj:
 - 2.1. Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10 (MF) 15.12.2020.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07-P- 082 të datës 09.11.2020, jep mendim lidhur me Nismën legislative për Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, si në vijim:
 - 1.1. Nisma legislative nga pika 1. e këtij Vendimi ka përcaktuar shfuqizimin e Ligjit Nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, mirëpo nuk arrinë t'i adresojë të gjitha mangësitë e kësaj fushe dhe se nuk është plotësisht në harmoni me dispozitat e legjislacionit në fuqi, me legjislacionin e BE-së, si dhe nuk është harmonizuar me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;
 - 1.2. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në mendimin e tij për nismën legislative të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, ka konstatuar se nuk është bërë identifikimi i burimeve të financimit në ndarjet tjera buxhetore për mbulimin e kostos shtesë, prandaj nuk ka rekomanduar aprovimin e këtij Projektligji.
 - 1.3. Nisur nga rrethanat e lartëcekura, Qeveria e Republikës së Kosovës, ofron mendimin e saj që nisma ligjore si e tillë të plotësohet me rekomandimet e dala nga mendimi i Qeverisë, për çka Qeveria mbetet e përkushtuar të orfojë gjithë kontributin e saj.
2. Nese Kuvendi e vlerëson të nevojshme, Qeveria zotohet se do ta përfshijë në Programin e saj legjislativ për vitin 2021, Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, të cilin do ta hartojë në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, me legjislacionin e BE-së, si dhe me legjilacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe të njejtin do t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Ky Vendim së bashku me mendimet e institucioneve përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07 -P- 81 të datës 09.11.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për Fshatin Kabash.
2. Në rrjedhë të kësaj, sipas proceduarave përkatëse, të gjitha ministritë e lartëcekura kanë përcjellur opinionet dhe deklaratat e tyre sipas fushëveprimit përkatës të tyre, me të cilat është konstatuar si në vijim:
 - 2.1. Mendimi i Ministrisë së Kultures Rinisë dhe Sportit: [...] Mendjmë që këtë Projektligj duhet analizuar hollësisht në mënyrë që të adresohen rekomandimet e dhëna, si dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, në të kundërtën në këtë formë si është hartuar nuk do t'i shërbente qëllimit të projektligjit.
 - 2.2. Mendimi i Ministrisë së Pushtetit Lokal [...] Ministria vlerëson se Ruajtja e resurseve natyrore, trashëgimië kulturore si dhe promovimin i tyre janë dhe obligim i organeve të komunave, që burojnë nga legjislacioni në fuqi për vetëqeverisjen lokale, dhe ne vlerësojmë se një projektligj do të ishte në favor të zhvillimit dhe të funksionimit më të mirë të Fshatit Kabash dhe përmisimit të kushteve të jetesës për banorët e këtij fshati.
 - 2.3. Mendimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit [...] sipas nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputetët e Kuvendit kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje, mirëpo, qëllimi i ruajtjes dhe promovimit të vlerave të Fshatit Kabash, mund të arrihet duke e shpallur atë peizazh të mbrojtur të natyrës konform vlerave natyrore, kulturore dhe historike që ka Fshati Kabash dhe konform rregullave të planifikimit hapësinor. Ministra e Ekonomisë dhe Ambientit është e mendimit se Projektligji i propozuar për Fshatin Kabash, nuk duhet të shkoj në procedure të miratimit, për shkak të arsyeve të lartëpërmendura.
 - 2.4. Opinionin e Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave [...] Projektligji për Fshatin Kabash, të Komunës së Prizrenit krijon kosoto shtes buxhetore në shumë prej 18.000 euro për vitin 2021-2023, shumë kjo që nuk është e planifikuar në projeksionet buxhetore për vitet 2021-2023 për Komunën e Prizrenit si zbatuese në praktik të këtij Projektligji.

- 2.5. Opinionin e Përputhshmërisë me Acquis të BE-së: Dispozitat e Projektligjit për Fshatin Kabash nuk janë të rregulluara me legjislacion të BE-së dhe si e tillë kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencë të mbrendshme të shteteve anëtare të BE-së.
3. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 07 -P- 83 të datës 09.11.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.
2. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikim e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze lidhur me Amendamentin Nr.1 të Marrëveshjes lidhur me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Komisionit Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për Anëtar në Bordin e organit Shqyrtues të Prokurimit Publik/OSHP i emëruar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/100 të datës 26.04.2019.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik i propozon Kuvendit të Republikës këta kandidat:
 - 2.1. Vjollca Kurtishaj;
 - 2.2. Erëlehta Popaj;
 - 2.3. Shqipe Hoti;
 - 2.4. Ardita Morina;
 - 2.5. Bujar Lushaku;
 - 2.6. Pranvera Maloku.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë të propozuarve sipas këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahxim dhe Verifikim të Pronës, i emëruar me Vendim të Kryeministrit nr.250/2020 me datën 16.11.2020.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës për pozitën e Zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahxim dhe Verifikim të Pronës/AKVP, këta kandidatë:
 - 2.1. Sadik Kryeziu;
 - 2.2. Milaim Çekaj;
 - 2.3. Albiona Maloku;
 - 2.4. Arben Krasniqi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë të propozuarve sipas këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/09, i datës 01.07.2020 për sistemin e përkohshëm të strukturave të ish MIE-së.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Pas miratimit të Rregullores Nr. (ZKM) 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, me Vendimin e Kryeministrit Nr. 251/2020, të datës 16.11.2020 dhe pas internalizimit të ish strukturave të ish MIE-së në kuadër të strukturës organizative të Zyrës së kryeministrit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenet 6, 10 dhe 11 të Marrëveshjes Kornizë në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian mbi Marrëveshjet për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II), si dhe në nenin 4 të Rregullores (QRK) - nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - 07/2020, si dhe nenin 19 të Rregullorës Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe në pajtim me nenin 41 (2.5) të Rregullores (ZKM) Nr. 01 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të mbajtur më 7 dhjetor 2020 merr këtë:


V E N D I M

1. Drejtori i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim caktohet Koordinator Kombëtar për IPA.
2. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/117, i datës 22.01.2020.
3. Teksti i pikës 1. të këtij Vendimi bëhet pjesë përbërëse e pikës 3 dhe vendoset si pikë e re 3.1 në kuadër të Vendimit të Qeverisë nr. 10/141 të datës 07.04.2017.
4. Kryeministri i Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 11, paragrafin 1 të Marrëveshjes Kornizë në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian mbi Marrëveshjet për Zbatimin e Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA II) do të njoftojë Komisionin Evropian për caktimin e Koordinatorit Kombëtar për IPA.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Pas miratimit të Rregullores Nr. (ZKM) 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, me Vendimin e Kryeministrit Nr. 251/2020, të datës 16.11.2020 dhe pas internalizimit të ish strukturave të ish MIE-së në kuadër të strukturës organizative të Zyrës së kryeministrit, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOPI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza e Treguesve për mbrojtjen e Fëmijës.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Treguesve nga pika 1. e këtij vendimi, për bashkëpunimin dhe ofrimin e ndihmës brenda kompetencave ligjore, në rastet kur kërkohen nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, për përmbushjen e obligimeve që dalin nga "Korniza e Treguesve për mbrojtjen e Fëmijës".
3. Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë monitoron zbatimin e Treguesve nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 12/43 i datës 13.11.2020 për themelimin e Komisionit Ekzekutiv për Reformën në Fushën e Inspektimeve.
2. Paragrafit 1. të vendimit bazë i shtohet edhe një (1) përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/43 të datës 13.11.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndermarrja Publike Lokale "Eko Natyra Sh.A. Skenderaj".
2. Ndermarrja Publike Lokale NPL "Eko Natyra Sh.A. Skenderaj", themelohet me 100% aksione nga KK Skenderaj.
3. Komuna e Skenderajt autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të NPL Eko Natyra dhe të ndermarr të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë edhe regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-016 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. nr. 09/24 maj 2018).
4. Komuna e Skenderajt të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtroj nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të komunës përkatëse bazuar në legjislacionin në fuqi
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Bifurkacioni" Sh.A, në përbërje të:
 - 1.1. Faruk Lipovica- Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Burbuqe Xheladini - anëtare;
 - 1.3. Abetare Kurti- anëtare;
 - 1.4. Negjmedin Bajrami - anëtar.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet pas ndryshimit të statusit të Ndërmarrjes në Ndërmarrjes Publike Qendrore, në përputhje me nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Bifurkacioni" Sh.A., shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve, sipas rregullimit në nenin 43 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe do të ushtroj përgjegjësitë mbështetur në legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- NP Bifurkacioni Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/48

Datë: 04.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligji Nr. 06/L -079 për Eficiencë të Energjisë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë për periudhën 2019-2021.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit si dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. paragrafi 1.6 e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/143 të datës 28.04.2017, si në vijim:

1.6. Ilir Gutaj, Departamenti për Drejtësi Tranzicionale, Ministria e Drejtësisë, anëtar.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/143 të datës 28.04.2017.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HËTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 4. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/15 të datës 22.07.2020, ashtu që afati paraparë për paraqitjen e raportit nga Grupi i Ekspertëve shtyhet deri më datën 15 Dhjetor 2020.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë, për themelimin e Grupit punues për përgatitjen e analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, në këtë përbërje:

- 1.1. Agim Gashi, përfaqësues nga Kryqi i Kuq, vëzhgues;
- 1.2. Ahmet Grajçevci, përfaqësues nga Këshilli i Shoqatave të familjarëve të zhdukur;
- 1.3. Arsim Gërxhaliu, përfaqësues nga IML, anëtar;
- 1.4. Baki Sfirca, përfaqësues nga MD, anëtar;
- 1.5. Behxhet Shala, përfaqësues nga KMDL NJ, anëtar;
- 1.6. Drita Hajdari, përfaqësuese nga Prokuroria Speciale, anëtare;
- 1.7. Fadil Gashi, përfaqësues nga Policia e Kosovës, anëtar;
- 1.8. Feride Rushiti, Përfaqësuese nga QKRMT, anëtare;
- 1.9. Hysen Azemi, përfaqësues nga Shoqata e Arkivave të Kosovës, anëtar;
- 1.10. Jahja Lluka, anëtar;
- 1.11. Kushtrim Gara, përfaqësues nga Komisioni Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, anëtar;
- 1.12. Luigj Ndou, përfaqësues nga ICMP, anëtar;
- 1.13. Meriman Braha, përfaqësues nga Shoqata e të burgosurve politikë, anëtar;
- 1.14. Nesrete Kumnova, nga Shoqata "Thirrjet e Nënave" anëtare;
- 1.15. Përfaqësues nga Fakulteti Juridik apo Ekonomik, anëtar;
- 1.16. Përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, anëtar;
- 1.17. Përfaqësues nga Shoqata e Veteranëve të luftës, anëtar;
- 1.18. Sanije Ismajli, përfaqësuese nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtare;
- 1.19. Sheremet Ahmeti, ekspert, anëtar;
- 1.20. Valentina Vitali, përfaqësuese nga EULEX-i, anëtare.

2. Grupi punues për përgatitjen e analizës për themelimin e Institutit për hulumtimin e krimeve të luftës do të ketë mandat për çështjet si në vijim:

- 2.1 Të ofroj një analizë/studim të argumentuar mbi mundësinë e themelimit të një mekanizmi për hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë;
- 2.2 Të identifikojë praktikën me të mira krahasuese dhe të pasqyrojë elementet dhe specifikat që mund të përfshihen në rastin e Kosovës.

3. Grupi punues deri me datën 31.12.2020 Ministrisë së Drejtësisë do t'i paraqes analizën me opcionet që duhet ndjekur për themelimin e Institutit për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë që Grupit punues t'i ofroj mbështetjen e nevojshme administrative dhe teknike.
5. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 45/2020 i datës 13.05.2020.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Anëtarëve të grupit të ekspertëve
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 78 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për kryetar dhe anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Bahri Anadolli- Kryetar;
 - 1.2. Hazir Hajdari - anëtar;
 - 1.3. Mark Buzhala- anëtar;
 - 1.4. Iliriana Berisha- anëtare;
 - 1.5. Faruk Rexhaj- anëtar.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOJI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Lotarinë e Republikës së Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/48

Datë: 07.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 të Ligjit nr. 07/L-001 Mbi ndarjet Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen kërkesat e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorve të Luftës së UÇK-së, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës të cilat i bashkangjiten këtij vendimi, për ndarjen e mjeteve finansiare në vlerën prej 203,000.00 €, nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike.
2. Mjetet e parapara sipas pikës një (1) të këtij vendimi merren nga nënprogrami 005/Asistenca Sociale – Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve dhe transferohen në nënprogramin 003/Invalidët e Luftës – Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumën 191,000.00 € dhe në nënprogramin 001/ Pensionet Bazike Sociale – Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në shumën 12,000.00 €.
3. Sipas pikës një (1) të këtij vendimi mjetet ndahen si vijon:
 - 3.1. Mjetet finansiare në shumën prej 17,000.00 euro, transferohen në Shoqatën e Familjes së Dëshmorve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e ProCredit Bank nr. 1110270777000187, të cilat mjete do të realizohen për aktivitetet e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve për 12 muaj.
 - 3.2. Mjetet finansiare në shumën prej 34,000.00 euro transferohen në Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e ProCredit Bank nr. 1701001010734491, të cilat mjete do të realizohen për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.
 - 3.3. Mjetet finansiare në shumën prej 15,000.00 euro transferohen në Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e ProCredit Bank nr. 1110003683000163, të cilat mjete do të realizohen për mbulimin e shpenzimeve për funksionimin e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.
 - 3.4. Mjetet finansiare në shumën prej 125,000.00 euro transferohen në Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e ProCredit Bank nr. 1110003683000163, të cilat mjete do të realizohen për mbulimin e shpenzimeve për protezave për Invalidët e Luftës së UÇK-së.

- 3.5. Mjetet financiare në shumën prej 12,000.00 euro transferohen në Lidhjen e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës, në xhironlogarinë e NLB nr. 1701001010343096, Prishtinë, të cilat mjet do të realizohen për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve dhe funksionimit të Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, në kuadër të së cilës janë 30 Organiata Komunale të Pensionistëve.
4. Mjetet e parapara sipas pikës një (1) shfrytëzohen vetëm për qëllimet e specifikuar në kërkesat përkatëse.
5. Organizatat përfituese sipas këtij vendimi obligohen pas tre (3) muajve të dorëzojnë raporte financiare \raportojnë pas tre muajve në MPMS.
6. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Shoqata e Familjes së Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, dhe Lidhja e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Për shkak të gjendjes emergjente të shkaktuar nga COVID-19 dhe për shkak të gjendjes së rëndë për funksionimin e rregullt të organizatave të lartpërmendura dhe me qëllim të lehtësimit në kryerjen e obligimeve ndaj anëtarëve të tyre aprovohen kërkesat Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës në kuadër të Fondit për Rimëkëmbje Ekonomike.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë